



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut , Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione  
Nr. 05/08  
Prishtinë me 19 .mars 2008 në orën 13,00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**P R O C E S V E R B A L**

**I mbledhjes se Komisionit për të Drejtat e Njeriut ,Barazi Gjinore,  
Personat e Pagjetur dhe Peticione**

Në mbledhje morën pjesë : Ismet Beqiri, kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujoviç, Nerxhivane Dauti, Naim Rrustemi, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati anëtarë.

Komisioni për këtë mbledhje kishte ftuar:  
Haki Kosumi kryetar i këshillit koordinues, familjeve e personave të zhdukur,  
Bajram Qerkini zëvendës i kryetarit të këshillit koordinues dhe  
Mediet

Kryetari hapi mbledhjen dha pasi e përshëndeti Haki Kosumin kryetar i Këshillit koordinues të Asociacioneve, familjeve e personave të zhdukur dhe z. Bajram Qerkini zëvendës i kryetarit të këshillit koordinues,i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës

Komisioni me propozimin e Kryetarit, miratoi :

***RENDIN E DITËS***

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Takim pune me kryetarin e këshillit koordinues, familjeve e personave të zhdukur,
3. Shqyrtimi i disa peticioneve ,
4. Të ndryshme  
Rendi i ditës u miratua .

U hap shqyrtimi për pikën e parë

- 1 Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**  
Pasi nuk pati vërejtje ai u miratua
- 2 Takim pune me Haki Kosumi kryetar i Këshillit Koordinues, të Asociacioneve të familjeve për personat e pagjetur .**

**Ismet Beqiri**, kryetar – pasi i përshëndeti i njoftoi mysafiret ,për se afërmi me punën që është bërë në zbardhjen të pagjeturve dhe paraqet shqetësim . Në vazhdim ceku se në legjislaturën e dytë nuk ka ekzistuar ky komisioni, dhe është ndije mungesa e tij, në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur Mirëpo deri me tani komisioni ka marrë disa veprime konkrete siç është – rekomandimi dërguar Qeverise se Kosovës për emërimin e kryetarit të Komisionit Qeveritar për personat e zhdukur dhe ka kërkuar që përsëri Qeveria të ripërsërisë kërkesën për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur për të cilët dyshohet se janë varrosur në territorin e shtetit Maqedoni. Ndërsa sa i përket infrastrukturës ligjore ceku se Komisioni ka marrë nisëm për hartimin e Projektligjit për personat e pagjetur ,me qëllim kjo kategori personave të rregullohet . Pastaj, në vija të trasha i njoftoi me planin e punës të Komisionit dhe e ftoi kryetarin këshillit koordinues që të marri fjalën.

**z. Haki Kosumi-** në fillim e përshëndeti kryetarin për ftesën që iu është bërë dhe shtoi: e përgëzoi këtë komision dhe beson në rezultatet e tij nuk do t'i mungojnë duke kërkuar një bashkëpunim të përbashkët .me tutje ceku se çështje e personave të pagjeturve kërkon zgjedhje dhe deri me tani institucionet nuk kanë punuar sa duhet, duke kërkuar të behet trysni tek organet që merren me këtë fushë. Pastaj, kërkoi që t' i lejohet në hartimin e planit strategjik si në zbatimin e rezolutës vitit 2003 dhe deklarata për çështjen e pazgjedhur të pengjeve të luftës të të rrëmbyerve dhe të të pagjeturve e viti 2005 të miratuara nga Kuvendi i Kosoves .Ne fund kërkoi për sigurimin e një zyre pasi nuk ka lokal ku mund të ushtrojnë veprimtarin duke u ballafaquar me kushte të vështira. Pastaj diskutoi Bajram Qerkini lidhur me këtë çështje duke iu kërkuar institucioneve të punohet në zbardhjen e fatit të pagjeturve.

**Ibrahim Makolli-** duke u ndërlidhur me parafolësit nënvizoi : Me këtë fushë jam marr që nga viti 1998, pra në masakrat e para të kryera në Skenderaj dhe në Poplek të Drenasit, duke u përpjekur që në vazhdimësi të japi kontributin në drejtim të zbardhjes se të pagjeturve. Ai u pajtua me parafolësit, se pas luftës janë përjashtuar vendoret nga ky proces por ai shtroi pyetjen- Se me faji të kujt? Në nuk kemi mundur të gjemë një gjuhë të përbashkët mes institucioneve dhe OJQ-ve, duke kërkuar për një bashkëpunim e sidomos me komisionin Qeveritar për personat e zhdukur . Prandaj , vuri në pah ,nuk lejohet se cili të dhënat të ketë për veti. Ai kërkoi nga ata që t'i dërgojnë organeve duke ofruar zgjidhje përmes përkrahjes se institucioneve do të kemi rezultate pozitive Ky mos koordinim , bashkëpunim ka munguar e si pasojë e kësaj kemi këtë gjendje. A e mbështeti këshillin që pa pengesa të ushtroi veprimtarin e tij duke iu krijuar kushte që të përfshihen edhe ato organizata të cilat nuk janë pjesë e këtij asociacioni. Prandaj ,këtë çështje do ta ngrisë në të gjitha nivelet.

**Sanije Alijaj** – nënvizoi: komisioni Parlamentar do të ketë për detyrë t'i shtyj proceset përpara me qëllim të zbardhjes se fatit të personave të pagjetur dhe se në këtë legjislatura

do të plotësohet vakum i ngelur ,pra fjala është në implementimin e rezolutës se vitit 2003 , qe për shkaqe të statusit të pazgjedhur të Kosovës ka ngelur pa u zbatuar. Ajo e mbështeti z. Makolli lidhur me politiken e koordinimit të punëve mes Asociacioneve dhe Komisionit.

**Luljeta Shehu** –përshëndeti koleget për prezantimin e gjendjes dhe shtoi: Lidhur me Personat e Pagjetur janë mbajtur shumë takime në nivelin vendor dhe ndërkombëtar por do të veçoja dy si më të rëndësishme,

Konferencës Ndërkombëtare për Personat e Zhdukur të mbajtur në Gjeneve me 19-21 shkurtë 2003 dhe nxori një deklaratë si dhe ,Konferenca e Ohrit e mbajturën në vitin 2007. Ku është kërkuar qe të intensifikohet procesi i gërmimeve dhe i identifikimeve të personave të zhdukur ,të hapen varrezat për të cilat dihet ,të kërkohej varreza të tjera të mundshme të hetohen akuzat për djegieve të trupave dhe të shqyrtohen rastet e identifikimit .Ajo në fund shtoi disa pyetje për mysafiret si vijon:

Pyetja sa keni informuar familjaret me deklaratën dhe parimet e konferencës?

Pyetja – Sa është numri i kallximeve penale të ngritura nga familjaret ,

Pyetje- Sa jeni duke punuar për ndërtimin e kompleksit memorial, ku do ruheshin rrobat e personave të pagjetur etj. ?

Pyetja- Sa po zbatohen rekomandimet e Komisionit Parlamentar për Personat e Pagjetur te miratuar nga legjislatura e par?

Përgjigje nuk iu dhënë pyetjeve të shtruarra .

**Drita Maliqi** – u pajtua me parafolësit dhe kërkoi komisionit të ketë bashkëpunim me asociacionet qe mirën me personat e pagjetur, pra u kërkuar të ftohen në dëgjime publike dhe të japin kontributin lidhur me Projektligjin për të personat e zhdukur. Propozimi , i sajë u mirëprit nga të pranishmit.

**Naim Rrustemi** – vuri në pah: Nuk duhet të mirën drejtimet në qasje negative kinse njëra po i ndërhyjnë në kompetenca, por përkundrazi, kjo nuk e dëmton kerkendë Ai propozoi Komisionit për ketë të nxirë konkluzionet.

**Hajredin Hysen** – shtoi : Vetë ekzistimi i shoqatave nuk e pengon askënd ,por përkundrazi e begaton dhe me punë qe është bërë deri me tani nuk jemi të kënaqur, prandaj kërkohet një bashkëpunim dhe renditje të punëve mes shoqatave dhe dy komisioneve Ai u premtoi se shqetësimet e tyre lidhur me zyre do t’ia prezantojë Qeverisë

**Nerxhivane Dauti** – pasi përshëndeti mysafiret që e njoftuan komisionin me gjendjen në ketë fushë Ajo nënvizoi- diskutimi i z. Bajram me ka shqetësuar, prandaj do ofrojë të gjithë potencialin psikik ,fizik në të mirën e tuaj, dhe do të japi kontributin në sigurimin e infrastrukturës ligjore projektligjit për personat e pagjetur. Ajo beri vërejtje se ne ketë drejtim nuk është punuar sa duhet. Lidhur me ketë çështje diskutoi edhe **Zllatica Vujović** e cila u angazhuar për një bashkëpunim të mirëfilltë dhe se vete ato familje qe kanë të pagjetur e dinë se çka do të thotë,e njëra nga ato jam edhe unë. Ishte konstatim i dy anshëm i Këshillit koordinues të asociacioneve për familjet personave të pagjetur se përkundër kushteve të vështira që kanë, bashkëpunimi nuk do të mungojë me ketë komision dhe lidhur me ketë pikë nxori këto :

## P E R F U N D I M E

1. **Komisionit dhe Këshilli i Asociacioneve të familjeve për personat e pagjetur do të bashkëpunojnë në të ardhmen**
2. **Komisioni do marr nisëm për hartimin e Projektligjit për personat e pagjetur,ndërsa draftimin do të bëjë Qeveria, kontributin në amendamentimin e tij do të japim ne si Komision,**
3. **Të kompletohen dosjet duke ua sjellë dy komisioneve për personat e pagjetur,**
4. **Të kërkohet nga Qeveria e Kosovës për sigurimin e një zyre Këshillit të Asociacioneve për familjet e personave të pagjetur,**
5. **Në mbledhjet e Komisionit rregullisht do të ftohen këtë asociacione, sidomos kur debatohet për personat e pagjetur.**

### 3 Shqyrtimi i disa peticioneve.

**Nerxhivane Dauti** - e njoftoi Komisionin me përmbajtjen e disa peticioneve vendosjen e tyre si vijon: Nedime Belegu, Ramiz Bllaca, Hajdin Beka,Saqip Ibrahim,Gani Thaçi,PDAK\_së, dhe Behar Idrizi ,duke iu ofruar udhëzime me shkrim për realizimin e të drejtave të tyre të institucionet e Republikës se Kosovës . Komisioni e falënderoi Nerxhivane Dautit dhe kërkoi,të njëjtat t'ju procedohen palëve.

### 4 Të ndryshme

Komisionin e ka njoftua kryetari me takimin që ka zhvillu me kryetaret e komisioneve parlamentare dhe z. Jakup Krasniqi kryetar, lidhur me këtë pikë nxori këtë;

## P e r f u n d i m

Kërkohet, nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës të shqyrtoj kërkesën për lejimin e mjeteve financiare të parapara me rregullat e buxhetit të konsoliduar të Kosovës për sigurimin e shtypit ditor për kryetaret e komisioneve të Kuvendit të Kosovës .

Mbledhja përfundoi në orën 13,30.

Procesverbalin e hartoi  
Rrahim Demaj ,zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit  
Ismet Beqiri

---

